



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ANALIZË PRELIMINARE
E KËRKESAVE FINANCIARE PËR KUVENDIN KOMUNAL
MAMUSHË
PËR VITET 2014-2016

Planifikimi i Buxhetit për vitin 2014 dhe Projektionet për vitet 2015 dhe 2016

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Mamushës, është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2014/2016, të dhëna nga MF (Ministria e Financave) përmes Qarkores buxhetore 2014/01 dhe 02 për Komunitet si dhe financimi nga grantet ndërqeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit komunal për vitin 2014 dhe parashikimet për vitet 2015,2016. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale, paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore – Komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetet të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Mamushës, si dhe projektionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2014 – 2016 gjithnjë duke u bazuar në :

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
- Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

❖ OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2014 – 2016 planifikohet në bazë të Buxhetit i cili bazohet në “Buxhetin e Programeve “ dhe është i orientuar në objektivat dhe në deklaratat e Misionit të Programeve. KAB 2014 – 2016 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr 2014/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Është pjesë përbërëse e KASH-it të Republikës së Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të tashëm është përfshirja e “Kornizës afat mesme të shpenzimeve”. Kjo na ka mundësuar që të planifikojmë të hyrat dhe shpenzimet jo vetëm për vitin pasus, por edhe për dy vite të ardhshme. Ajo që tani na duhet është definimi i “ Misionit tonë” së paku për tri vite tjera të kthyer në objektiva, programe, veprime dhe shifra.

❖ **Objektivat e Komunës së Mamushës:**

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së komunës
- Hartimi i planit zhvillimor të Komunës dhe planeve rregullative në zonat urbane
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale
- Ngritja e nivelit të Arsimit dhe Edukimit
- Zhvillimi i sferës së Kulturës, Sportit dhe Rinis
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme
- Përmirësimi i nivelit të kooperimit ndëretnik
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor

❖ **Objektivat shtetërore**

- **Përkrahjes dhe krijimit të parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;**
- **Qeverisjes së mirë dhe fuqizimit të sundimit të ligjit;**
- **Zhvillimit të kapitalit njerëzor;**
- **Rritjes së mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.**

Siq mund të shihet objektivat e komunes janë të lidhura ngusht me objektivat e shtetit të kosoves.

Ky dokument ka për qëllim të:

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore.
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritare të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat.
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë nivel të ulët të deficitit fiskal.

❖ Komuna e Mamushës ka këtë strukturë të programve:

160 - 16014	Zyra e Kryetarit
169 - 16914	Zyra e Kuvendit Komunal
163 - 16314	Administrata dhe Personeli
175 - 17514	Buxheti dhe Financat
180 - Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	
18418 - Zjarrfikësit dhe inspektimet	
18014 - Infrastruktura Rugore	
197- 19770	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
650 - 65070	Kadastrë , Gjeodezi dhe pronë
730 - Shëndetësia primare	
73028	<i>Administrata e Shëndetësisë</i>
73850	<i>Shërbimet e shëndetësisë primare-Çendra Mjekësive Familjar</i>
75565	<i>Shërbimet Sociale</i>
920	Arsimi dhe shkenca
92070	<i>Administrata</i>
92470	<i>Arsimi parafillor dhe çerdhet</i>
93390	<i>Arsimi fillor</i>
94590	<i>Arsimi i mesëm</i>

Objektivat:

a). Shtimi i efikasitetit gjatë operacioneve

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur
- Përzgjedhja e punëve më prioritet për realizim

b). Rritja e shpejtë e të ardhurave

- Rritja e efikasitetit në inkasim
- Zgjerimi i bazës tatimore

c). Kontrolli i shpenzimeve dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë

- Përparësia nga blerja me shumicë
 - Përmirësimi i specifikacionit për mallra dhe shërbime
 - Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat me afat të gjatë
- d). Zhvillimi i aftësive

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore
 - Përdorim i gjerë i kompjuterit
 - Profesionalizimi i shërbimeve
- e). Të sigurohet disiplina financiare

- Pajtueshmëria me politikën financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet
- Ekzistenca e kontroleve interne – Auditori i Brendshëm
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik
- Analizat të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve
- Realizimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh Plani)

f). Ekonomia

- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik
- Krijimi i kushteve për investime të huaja
- Strategjia për zhvillimin rural

Programet

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar
- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme

- Ngarkesa të reduktuara

c. *Ristrukturimi organizativ*

- Shqyrtimi i strukturës organizative Organogrami i Ri

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Zbatimi i rregulloreve komunale
- Kujdesi ndaj palëve
- Shqyrtimi i planit të punës 2013
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës 2014
- Përgatitja e Kornizës së shpenzimeve afatmesme 2014-2016
- Përgatitja e planit urbanistik , rregullativ dhe detal
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të dhënave dhe përdorimi
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi

Udhëzimet kryesore nga Ministria e Financave janë:

- (a) LIMITET e grandeve që do t'i caktojë Qeveria Qendrore për Komuna
- (b) Buxheti duhet të jetë I BALANCUAR. Kjo do të thotë se Komuna NUK MUND TË bëjë planin për shpenzime e cila tejkalon grandet e lejuara dhe nuk mund të përgatisë buxhetin deficitar.

1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH).

	Programet	Nr.Punëtorve	Planifikimi	Parashikimet	
			2014	2015	2016
	Zyra e Kryetarit	10	71,559.00	81,466.00	81,466.00
	Zyra e Kuvendit Komunal	15+4	57,057.00	57,857.00	57,857.00
	Administrata dhe personeli	11	164,079.00	149,060.00	123,689.00
	Buxheti dhe financat	6	33,723.00	47,221.00	47,221.00
	Kadastër, gjeodezi dhe pronë	5	22,618.00	23,918.00	23,918.00
	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	12	386,355.00	391,155.00	439,953.00
	Infrastruktura rrugore	2	339,650.00	344,350.00	393,148.00
	Zjarrfikësit dhe inspektimet	10	46,705.00	46,805.00	46,805.00
	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	2	9,938.00	11,038.00	11,038.00
	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	21	145,494.00	157,682.00	160,286.00
	Shërbimet e shëndetësisë primare	17	124,867.00	135,185.00	137,789.00
	Administrata e shëndetësisë	2	11,622.00	11,622.00	11,622.00
	Shërbimet Sociale	2	9,005.00	10,875.00	10,875.00
	Arsimi dhe shkenca	69	381,786.00	387,665.00	391,225.00
	Administtrat e Arsimit	5	30,736.00	36,156.00	36,156.00
	Arsim Parashkollor	3	13,695.00	13,695.00	13,695.00
	Arsim Fillor	54	288,023.00	282,068.00	285,628.00
	Arsim i Mesëm	7	49,332.00	55,746.00	55,746.00
	TOTALI	136	1,272,609.00	1,307,062.00	1,336,653.00

Korniza makroekonomike e komunës është sipas Qarkores nr. 2014/0i dhe 0/2 për Komuna

Korniza Afatmesme Makroekonomike e Komunës sonë është ne përputhje me Kornizën Afatmesme Makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve që dalin nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH).

Ne përgjithësi mund të thuhet se fondet nga Grandi Qeveritar dhe Te Hyrat Vetjake Komunale për momentin nuk paraqesin potencial të mjaftueshëm financiar për zhvillimin e komunës, meqë nga te hyrat e përgjithshme 90 % e mjeteve buxhetore shpenzohen për investime publike.

		Vlerësimi	Projeksioni	Projeksioni
Nr.	Programi buxhetor	2014	2015	2016
1	Administrata e Përgjithshme	731.792,00	752.478,00	774.607,00
2	Arsim dhe Shkenca	355.950,00	359.509,00	363.069,00
3	Shëndetësia	121.867,00	130.185,00	132.789,00
4	THV	63.000,00	64.890,00	66.188,00
	Total:	1.272.609,00	1.307.062,00	1.336.653,00

1.2. Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë, të cila të hyra duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

Të Hyrat e Komunës përbëhen nga:

- o Tatimi në pronë
- o Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- o Taksat për lejen për shërbime profesionale
- o Taksa për automjete motorike
- o Taksa administrative komunale
- o Taksa për certifikata
- o Partipicim-pagesat në shëndetësi
- o Të hyra tjera*

Përveç të hyrave nga tatimi në pronë edhe taksa komunale në biznes tregon një kategori të rëndësishme të të hyrave vetjake komunale . Gjatë planifikimit të kësaj kategorie kemi pas parasysh që një numër i konsiderueshëm i bizneseve komunale nuk janë duke funksionuar. Taksa komunale për leje ndërtimi është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave , gjatë planifikimit të kësaj kategorie komuna ende nuk është e sigurt me kategorinë e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. (Të gjitha objektet që nuk janë të legalizuara, mirëpo janë pjesë e planit urban do të legalizohen).

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake Komuna ka formuar një Komision për Ngritjen e Performancës së të hyrave vetanake.

Tabela 2. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale(THV) për vitin 2014 - 2016

Komuna e Mamushës		Formulari THV - 2014	Formulari THV - 2015	Formulari THV - 2016
		në Euro	në Euro	në Euro
Nr.rendor	Burimet e të Ardhurave	Totali	Totali	Totali
I-A.	TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte			
1	Licencat komerciale dhe të biznesit / Lejet	24,300	26,190	27,488
1.1.	Funksionimet e dyqaneve të mëdha dhe shërbimeve tjera	24,300	26,190	27,488
1.2.	Funksionimet e aktiviteteve industriale ose aktiviteteve të lidhura me ndërtimin			
1.3.	Funksionimi me shitore në rrugë ose afër rrugëve,kioske,karroca të vogla lëvizëse			
1.4.	Funksionimet e bankave, kompani .të sigurimit dhe shërbimeve tjera financiare			
1.5.	Funksionimet e Gurëthyesve,minierave			
2	Liçensat për lojra zbavitëse,pije alkoolike,reklamime,shpallje etj. / Lejet	0	0	0
2.1.	Funksionimet me makina me monedha ose me lojra dh të ngjashme	0	0	0
2.2.	Funksionimet dhe vendosja e shërbimit të pijeve alkoolike			
2.3.	Reklamimi, publikimi në pronën Komunale			
3	Liçensat profesionale / Lejet	-	-	-
3.1.	Funksionimi i shërbimeve profesionale (.Avokatët,Mjekët,Dendistet, etj.)	-		
4	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e ndërtimit			
4.1.	Lejet për ndërtim dhe konstruktive			
4.2.	Pagesat e ndërrimit të destinimit të tokës ekzistuese			
4.3.	Pagesat e demolimit	-	-	-
4.4.	Pagesat me ndikim nga shfrytëz.i madh i rrugëve publike apo i shërb.publ.të siguruar për ndërtim ose operim komerc. duke përfshirë edhe vendet e nxjerrjes se resurseve nat.	-	-	-
4.5.	Tatimet nga nxjerrja e Resurseve natyrore(Neni 10.5 CFA Udhëzim Ad...Nr.2001/03 dhe 2001/02 DLA)	-	-	-
5	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	2,000	2,000	2,000
5.1.	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	2000	2000	2000
5.2.	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit			
6	Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë			
6.1.	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik			
6.2.	Inspektimi i ambientit			
6.3.	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit			
7	Shfrytëzimi i pronës Komunale			

Komuna e Mamushës

7.1.	Baza ditore, bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale - jo komerciale			
7.2.	Ngarkesat për hapsirë në tregje ose në objekte të ngjajshme			
7.3.	Marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë			
7.4.	Të hyrat nga shitja e pronës komunale			
8	Pagesat në lidhje me Automjetet	7,200	7,200	7,200
8.1.	Lejet e automjeteve	-	-	-
8.2.	Parkimi në parkingun publik I paisur me garazhim apo hapsira tjera	-	-	-
8.3.	Gjobat në trafik	2,200	2,200	2,200
8.4.	Largimi dhe deponimi i automjeteve	-	-	-
8.5.	Regjistrimi i automjeteve	5,000	5,000	5,000
9	Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	5,500	5,500	5,500
9.1.	Pagesat e regjistrimit të pronës dhe të transferit			
9.2.	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të lindjes,vdekj,martesës,shkurorizimit	3,000	3,000	3,000
9.3.	Pagesat për kopjet shtesë të certifikatave/dokumenteve			
9.4.	Taksa administrative	2,000	2,000	2,000
9.5.	Të tjera	500	500	500
10	Taksa e pronës	12,500	12,500	12,500
10.1.	Pagesat e taksës së pronës	12,500	12,500	12,500
11	Të ardhurat tjera			
11.1.	Përfitimi nga privatizimi	-	-	-
11.2.	Regjistrimi i Biznesit -			
11.3.	Të hyrat nga kontestet e komunes	-	-	-
11.4.	Gjobat tjera	-	-	-
11.5.	Pagesat tjera	-	-	-
I - A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	39,700	39,700	39,700
1.1.	Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	6,000	6,000	6,000
1.2.	Të tjera	-	-	-
1.3.		-	-	-
1.4.		-	-	-
I - B.	Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	6,000	6,000	6,000
I	Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	45,700	45,700	45,700
	TË ARDHURAT NGA ARSIMI			
1	Qerdhet			
2	Arsimi parashkollor			
3	Arsimi fillor	-	-	-
4	Arsimi i mesëm	-	-	-
5	Mësimi joformal	-	-	-
6	Të tjera	-	-	-

Komuna e Mamushës

II	Totali – Arsimi			
	Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA	5,500	5,500	5,500
1	Shëndetësia primare	5,500	5,500	5,500
2	Të tjera (Nga të Hyrat Vetanake Komunale)	-	-	-
III.	Totali - Shëndetësia	5,500	5,500	5,500
Kodi 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I+II+III):			
IV.	Donatorët e mbrenshem (IV)			
1.1	Participimi I populates			
1.2	Grantet e donatorve te mbrendshëm (ministritë apo të tjerë)			
1.3	Të hyrat dhe donacionet tjera			
1.4	Tjera			
Kodi 31	Total (IV)			
V	Donatorët e Jashtëm (V)			
	Gjithsej të ardhurat e komunës (I+II+III+IV)	63,000	64,890	66,188

Komuna e Mamushës

Planifikimi i buxhetit për vitin 2014

Kodi Programit	Programi/ Nënprogrami	Stafi 2014	Pagat & Meditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime kapitale	Total
16014	Zyra e Kryetarit	10	61,559.00	7,000.00	-	3,000.00	-	71,559.00
16314	Administrata Personeli	11	43,343.00	39,236.00	8,500.00	0	73,000.00	164,079.00
16914	Zyra e Kuvendit		52,857.00	4,200.00				57,057.00
17514	Buxhet & Finaca	6	29,723.00	4,000.00				33,723.00
180	Sherbimet Publike	13	59,079.00	3,000.00	8,000.00	0.00	316,276.00	386,355.00
18014	Infrastruktura Rrugore	2	12,374.00	3,000.00	8,000.00		316,276.00	339,650.00
18418	Zjarëfikësit & Inspektimet	10	46,705.00					46,705.00
19770	ZKK	2	9,938.00			0.00		9,938.00
65070	Kadastra & Gjeodezia	5	22,318.00	300.00	-	-	-	22,618.00
730	Shëndetësia & Mirëqenia	22	105,420.00	17,000.00	2,300.00	0.00	20,774.00	145,494.00
73023	Administrata e Shëndetësisë	2	11,622.00					11,622.00
73850	Shërbimet Primare	17	84,793.00	17,000.00	2,300.00		20,774.00	124,867.00
75565	Shërbimet Sociale	2	9,005.00	0.00				9,005.00
920	Arsimi & Shkenca	69	325,763.00	27,900.00	3,000.00	0.00	25,123.00	381,786.00
92070	Administrata e Arsimit	5	25,836.00	4,900.00				30,736.00
92470	Arsimi Parafillor	3	13,695.00					13,695.00
93390	Arsimi Fillor	54	248,223.00	19,000.00	2,000.00		18,800.00	288,023.00
94590	Arsimi I Mesem	7	38,009.00	4,000.00	1,000.00		6323	49,332.00
	TOTAL	136	710,000.00	102,636.00	21,800.00	3,000.00	435,173.00	1,272,609.00

Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit: Në bazë të Ligjit Nr. 03/L – 040 Mbi vetëqeverisjen lokale Zyra e Kryetarit të Komunës, respektivisht Kryetari si organ i Komunës, ka këto përgjegjësi:

Kryetari duke përfaqësuar Komunën dhe duke vepruar në emër të saj udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe Administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij, ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës, propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës, si dhe nxjerr urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij, propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, si dhe ndërmerr aktivitetet tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo dispozita tjera ligjore në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve të përhershme dhe atyre ad hoc (koh pas kohe), gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisjeje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë e Kuvendit të Komunës gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës. Ofron qasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorive dhe konform ligjit, udhëzimeve, politikave dhe procedurave për menaxhim bënë implementimin e rregulloreve, vendimeve dhe aktiviteteve, duke përfshirë këtu edhe menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorive.

Organizon punën në organet komunale të administratës, duke përfshirë këtu edhe planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin optimal të tij.

Kuvendi i Komunës

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës dhe organet e tij (komitetet e përhershme dhe ato ad hoc), me subjektet relevante të nivelit qendror dhe ato lokal, OJQ-të, bizneset etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve, angazhohet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e Komunës sonë, duke përfshirë këtu ndërmarrjen edhe të aktiviteteve tjera të domosdoshme për kujdesin që qytetarët e Komunës të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim.

Drejtoria e Administratës dhe Personelit

Deklarata e misionit :

- Zbatimin e dispozitave ligjore, rregulloreve në organet e administratës komunale
- Organizon metodën e punës në organet komunale të administratës,
- Lëshon certifikata dhe akte tjera nga evidenca zyrtare që mban kjo drejtori,
- Planifikon buxhetin e Drejtorisë dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij,
- Kryen punët administrative për nevojat e këtyre organeve që kanë të bëjnë me :
- Përgatitjen profesionale, teknike dhe organizimin e mbledhjeve të Asamblesë Komunale, dhe trupave punues të emëruar nga Asambleja Komunale si dhe përpunimi profesional të akteve të miratuara nga këto mbledhje.
- Punët e përbashkëta për të gjitha organet e administratës: Punët e pranimit të shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare , vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivës dhe ekspeditimit, zbatimin e procedurave ligjore nga lëmia e marrëdhënies së punës, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, prokurimin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, nxehjen qendrore, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve të KK dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kompjuterëve.

Deklarata e Vizionit :

- Lëshon deklarata për amvisnin e përbashkët,
- Bën vërtetimin e fotokopjeve të dokumenteve origjinale
- Bën vërtetimin e nënshkrimeve personale
- Lëshon vërtetime për varëshmërinë materiale në diasporë etj,
- Lëshon certifikata në bazë të dy dëshmitarëve dhe provave tjera,
- Përgatitë aplikacionet për marrjen e patentë shoferëve dhe bënë shpërndarjen e tyre,
- Protokollon, pranon shkresat nga palët, sistemon, evidenton dhe dërgon aktet në përpunim të mëtejshëm sipas drejtorive dhe sektorëve të veçantë dhe bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit Komunal,
- Përpunimi administrativ-teknik i akteve dhe i lëndëve, pranimi , hapja, klasifikimi i postës, dërgimi i postës, arkivimi lëndëve, ruajtja e lëndëve arkivore të përfunduara
- Ndarja e materialit të pavlefshëm të regjistraturës dhe dorëzimi i lëndës arkivore ,arkivit kompetent, shpend e thirrjeve përmes centralit telefonik etj

Deklarata e Qëllimit :

- Drejtoria e Administratës dhe Personelit ka për qëllim të bëj:
- Regjistrimin e posalindureve në LAL
- Regjistrimin e të vdekurve në LAV
- Celebrimin e martesave dhe i regjistrojnë në LAM,
- Mbanë librat amzë të të lindurve,
- Mbanë librat amzë të të martuarve
- Mbanë librat amzë të të vdekurve
- Bënë ndryshime dhe përmasime të emrave personalë sipas kërkesës së palës
- Lëshon certifikata për faktet që mbajnë evidencë sipas detyrës zyrtare,
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me Ligj dhe aktet nënligjore,
- Bënë pregaditjen dhe organizimin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe përpunimin profesional të akteve të aprovuara në seanca , ruan dokumentacionin dhe burimet e dokumenteve, mban evidencës e mbledhjeve të mbajtura të Kuvendit dhe komiteteve të saj , mban procesverbalet dhe stenogramet nga seancat e Kuvendit, bën publikimin e vendimeve dhe akteve tjera të aprovuara në këto organe në Gazetën Zyrtare dhe mjete tjera të informimit,
- Kryen punë profesionale për anëtarët e Kuvendit, organeve të saja, lidhur me mirëvajtjen e punës sidomos: rreth peticioneve, ankesave, parashtrësive që në formë të ndryshme i drejtohen këtyre organeve dhe komiteteve të zgjedhura nga Kuvendi Komunal.
- Përgatit procedurat e nevojshme lidhur me tubimet publike të Kuvendit Komunal me qytetarë, bashkësitë lokale dhe organizmat tjerë relevant
- Jep instruksione profesionale lidhur me materialet që i shqyrton Kuvendi, Bordi i Drejtorëve dhe Komitetet e Kuvendit ,
- Kryen detyra tjera sipas udhëzimeve dhe urdhërësive të kryetarit të Komunës.
- Zbaton Ligjin mbi Shërbimin Civil dhe Zbaton Urdhëresat Administrative lidhur me zbatimin e procedurave të shpalljes së konkurseve, rekrutimit, selektimit, mirëmbajtjes së dosjeve të punëtorëve të shërbimit civil dhe të procedurave tjera që dalin nga Ligji dhe Udhëzimet Administrative që rregullojnë këtë lëmi.
- Është përgjegjëse për zbatimin e procedurës së tenderimit në bazë të rregullatave ligjore në fuqi
- Merret me administrimin e rrjetit të kompjuterëve , përpunimin e-Web-faqes së Komunës dhe përcjelljen e trendëve bashkohorë nga lëmi e teknologjisë informative

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Deklarata e misionit: Misioni i kësaj drejtorie është të bëjë menaxhimin e buxhetit dhe financave të komunës, i siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon liderët komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës. Përgatit rregulloret për KPF, menaxhimin e financave komunale, përgatitjen e prezantimit të buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktivitetëve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

Deklarata e vizionit: Menaxhon me buxhetin komunal, përgatit buxhetin komunal për të gjitha Programet buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MF-i duke u bazuar në Qarkoret Buxhetore dhe dokumentacionin plotësues, bën rishikimin buxhetor, analizat, raportet periodike financiare etj.

Prefeksionimi i mbajtjes së evidencës së kontabilitetit dhe mundësin për ngritjen në nivel më të lartë. Sektori i tatimit në pronë, menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në prone, përgatitjen e faturave, shpërndarjen e faturave tatimore, planifikimin e inkasimit të tatimit në prone, dhe raportimin e rregullt pranë MF.- zyrës regjionale dhe drejtorisë për realizimin e të hyrave nga tatimi mbi pronë në baza mujore si dhe përmbushja e planit vjetor për përfitimin e Grantit stimulues. Pasurimin dhe inkorporimin e elementeve shtesë për skemën e tatimit dhe freskimin vjetor të dhënave me gjendjen në teren dhe aprovimin ndryshimeve – plotësimeve të rregulloreve komunale të Tatimit mbi pronën dhe tarifave dhe ngarkesave dhe gjobave komunale.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i kësaj drejtorie është që të ngrit nivelin e menaxhimit të financave komunale për të gjithë administratën lokale, mbanë kontabilitetin dhe financat dhe përpilon raportet mujore dhe vjetore mbi financat komunale. Mbanë evidencën e kontabilitetit për të hyrat vetanake komunale për çdo program buxhetor si dhe barazimet periodike (mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore me MF-in Departamentin e Thesarit). Zyra menaxhon të gjitha shpenzimet e komunës, sipas udhëzimeve nga MF. Për secilën program buxhetor, përmes sistemit të kontabilitetit të Free-Balanced, përmes të cilit bëhet realizimi i shpenzimeve buxhetore (alokimi, zotimi dhe realizimi i pagesave) duke u bazuar në rrjedhjen e paras së gatshme Kesh – planit.

Kuantitative:

1. Do të përgatiten raportet buxhetore-financiare tre - mujore
2. Do të shpërndahen faturat mbi ngarkesën e tatimit në pronë
3. Përpilimi dhe aprovimi i buxhetit vjetor dhe rishikimi për Programet buxhetore komunale.....
4. Shpërndarja e Aktvendimeve të licencave të firmave
5. Futja e të dhënave buxhetore në sistemin – BDMS
6. Evidentimi – futja e projekteve kapitale në sistemin e PIP -it
7. Regjistrimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore

Planifikim, Urbanizëm, Kadastër, Pronë dhe Ambient

Deklarata e misionit : Misioni primar i drejtorisë është krijimi i një ambienti të shëndoshë për banim, punë, rekreacion duke respektuar rregullativën ekzistuese ligjore.

Drejtoria është bartëse kryesore e hartimit të detyrave projektuese për planet zhvillimore komunale – urbane dhe planeve rregullative urbane dhe benë implementimin e tyre, kujdeset për dokumentacionit investivo-teknik dhe perputhshmerinë e tij me kushtet e dhëna urbano-teknike. Lejon shfrytëzimin e hapsirave publike, mbulon sferën banimit, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë, bashkëpunimi i ngusht me qeverinë qendrore-Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Spektori për planifikim

Deklarata e misionit: Është bartëse për procedurat rreth hartimit të planit zhvillimor komunal - urban dhe planeve rregullative urbane, merret me monitorimin dhe evaluimin e këtyre planeve, harton propozimet dhe kushtet e dhenjes së pronës komunale në shfrytëzim me interes të përgjithshëm shoqëror, jep hapësirat publike në shfrytëzim të përkohshëm, kujdeset për zbatimin e ligjeve të sferës së planifikimit hapësinor si Ligjit për planifikim hapësinor të Kosovës (LPH), respektimit të rregullativës ekzistuese ligjore.

Spektori për urbanizëm

Deklarata e misionit: Kujdeset për implementimin e planeve zhvillimore dhe planeve rregullative urbane, lëshimin e lejeve të ndërtimit konform rregullativave ekzistuese kontrollimin e dokumentacioneve investivo-teknike, shfrytëzimin e sipërfaqeve publike në përputhje me rregulloret dhe realizimin e mjeteve financiare duke paraqitur shtyllën kryesore të të hyrave vetanake në buxhetin komunal.

Zyra për kadastrë

Deklarata e misionit: Zyra për kadastrë është përgjegjëse të kujdeset dhe të mirëmbaj të gjithë regjistrat kadastral, ku përfshihet e gjithë palujatshmëria komunale.

Zyra për gjeodezi

Deklarata e misionit: Zyra për gjeodezi është përgjegjëse të marrë vendime duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve për: matje, incizime, ndarje (në parcela), nëndarjet e pronave të tokës.

Zyra për pronë

Deklarata e misionit: Zyra për pronë bënë shqyrtimin e uzurpimeve të pronave, merr pjesë në procesin e espropioimit, të jap në përdorim të përkohshëm pronën komunale, të marrë vendime për shitblerjet e pronave

Drejtoria për Shërbime Publike, mbrojtja civile, emergjenca

Deklarata e misionit :

Për shkak të specifikave që e ngarkojnë drejtorinë , përgjegjësitë janë ndarë në sektore :

► **Spektori për Shërbime Publike** në të cilën bëhet planifikimi dhe përcaktimi i ofrimit të shërbimeve komunale për qytetarët, koordinimi i punëve me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrje komunale. Sektori për shërbime publike gjithashtu do të merret me mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve- verore dhe dimërore, mirëmbajtjen dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike, shenjëzimin horizontal dhe vertikal, mirëmbajtjen e varrezave

► **Spektori për Infrastrukturë** i cili në kuadër të kompetencave bënë planifikimin e investimeve kapitale në ndërtim, riparim dhe mirëmbajtjen në infrastrukturën e qytetit, konkretisht do të merret me ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e rrjeteve të ujësellsit, ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, ndërtimin e parqeve dhe shesheve si dhe kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta.

► **Spektori Zjarrëfikste dhe inspektimet** Mbrojtja dhe Shpëtimi i njerëzve, kafshëve, pasurisë, trashëgimisë së kulturës dhe natyrës nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera .

Deklarata e misionit: Që të zhvilloj dhe të siguroj me efektivitet dhe efikasitet: a) kushtet higjieniko-sanitare dhe teknike në ambientet ku qytetarët e Mamushës jetojnë, punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen, etj. b) normat dhe standardet e operatorëve që kryejn veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie, c) implementimin e masave dhe programeve preventive përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore,

Deklarata e Vizionit : Sistemi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmban programimin, planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e masave si dhe të aktiviteteve për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullativ dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejn veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e Mamushës.

Kuantitative:

1. Sektori Inspeksionit Sanitar, Veterinar, Bujqësi dhe Ambi.
2. Sektori Inspeksionit Tregut
3. Sektori Inspeksionit Ndërtimit

Drejtoria per Shëndetësi dhe Mireqenje sociale

Deklarata e misionit : Te siguroj dhe te zhvilloj sistemin e ofrimit te kujdesit pasresor shendetesor te bazuar ne nevoja te popullates sone,përkujdesjen sociale dhe te strehimit

Deklarata e Vizionit : Qe popullates sone tu ofrohen shërbime shendetesore ne përputhje me kriteret e OBSH-se,dhe ngritjen e kapaciteteve banesore dhe te shërbimeve te tjera per rastet e renda sociale.

Deklarata e Qëllimit : Implementimi i Ligjit te Shendetesise dhe normave te tjera Juridike qe kane per qellim ngritjen e te gjithë parametrave te cilet kishin me rezultue me shërbime shendetesore efikase dhe cilesore te popullates.

Kuantitative:

- 1.Edukimi Shëndetësor
- 2.Vaksinimi
3. Diagnostikimi i sëmundjeve dhe trajtimi i tyre
4. Sistemi informativ shendetesor
5. Infrastruktura.

Drejtoria e Arsimit

Deklarata e Vizionit :

a. Sektori i arsimit

- Qasja e drejtë dhe në mënyrë shkencore në avancimin e arsimit dhe edukimit të gjeneratave të reja, bazuar në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë, 2007 – 2017
- Modeli i zhvillimit të arsimit dhe edukimit të gjeneratave të reja nëpër vendet më të avancuara të regjionit, të Evropës e më gjerë,
- Krijimi i një ambienti të sigurtë e tërheqës për të gjithë nxënësit,
- Përmirësimi i pozitës materiale të punëtorëve arsimorë,
- Arritshmëria e një shkalle sa më të lartë të suksesit,

b. Sektori i kulturës qasja e drejtë ndaj kulturës dhe sportit si segmente shumë të rëndësishme në krijimin e një shoqërie moderne me vlera të qëndrueshme,

Deklarata e misionit :

a. Sektori i arsimit Edukimi i dhe arsimimi i gjeneratave të reja që nga niveli parashkollor deri tek shko-llimi i mesëm i lartë duke përfshirë të gjithë pa dallim etnie, race dhe përkatësie fetare.

- Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative të MASHT-it dhe ligjeve të Parla-mentit të Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me arsimin,
- Respektimi dhe zbatimi i vendimeve që dalin nga Bordi Ekzekutiv dhe Asambleja Komunale,
- Zbatimi dhe qasja e drejtë e reformave shkollore, me qëllim të arritshmërisë në shkallën më të lartë, bazuar në standardet evropiane dhe botërore,
- Zbatimi dhe qasja e drejtë në vlerësimin e njohurive të nxënësve,
- Nxitja e bashkëpunimit me të gjitha shoqatat dhe organizatat që kanë të bëjnë me lëminë e arsimit dhe edukimit,
- Bashkëpunimi me DKA-të në nivel të Kosovës,
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve,
- Bashkëpunimi me Zyrën e Inspektionit në nivelin regjional,
- Aftësimi profesional i personelit arsimor,
- Krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e mësimin,
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjnë me formimin e personalitetit të të gjithë nxënësve,
- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës shkollore,
- Përgatitja e objekteve shkollore për fillimin me kohë të vitit shkollor, kalendarit të punës, plan-programeve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik,
- Mbikëqyrja e përgjithshme e punës edukativo-arsimore,

Zyra komunale për komunitete

Deklarata e misionit: Qëllimi kryesor i kësaj Zyre është që të ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të gjitha komuniteteve të komunës me theks të posaçëm për minoritetet

Administrata

Deklarata e misionit: Planifikon, menaxhon dhe koordinon punën e sektorëve të ZLK. Menaxhon stafin, objektet dhe buxhetin e ZLK.

Planifikon, harton dhe mbikëqyrë realizimin e plan programit vjetor të punës. Raporton para Kuvendit, Kryetarit, Kryeshefit...

Zyra për Komunitete

Deklarata e misionit : Bashkëpunimi me komunitetet rreth çështjeve që kanë të bëjnë lidhur me kërkesat e Komuniteteve që adresohen ndaj qeverisjes lokale dhe që kanë të bëjnë me ofrimin e kushteve sa më të favorshme për një zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik, arsimor dhe kulturor për komunitetet dhe me këtë edhe të minoriteteve që jetojnë në komunën tonë, si dhe krijimin e kushteve jetësore për komunitetet.

Komuna e Mamushës

TABELA PËR INVESTIME KAPITALE 2014

Nr. Ren	Fondi	Emërtimi	Shuma €	Drejtoria / Program	Kodi i Progr.
	Burimor				
1	10	Automjet	20,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
2	10	Paisjet e IT- Makina Fotokopjuese	10,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
3	10	Ndërtimi objektit përcjllës për Administrat	38,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
4	10	Mobilje	5,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
5	10	Shtegu i lumit Topllua	64,276.00	Shërbime Publike	180
6	10	Rregullimi i rrugëve fushore bujqesore	34,000.00	Shërbime Publike	180
7	10	Shtuarja e rrugëve me kubeza	48,000.00	Shërbime Publike	180
8	10	Hapja e Pusit	5,000.00	Shërbime Publike	180
9	10	Riparimi i Sahat Kulles	20,000.00	Shërbime Publike	180
10	10	Kanalizim (lagjia e re)	20,000.00	Shërbime Publike	180
11	10	Automjet për pastrimin e rrugëve	25,000.00	Shërbime Publike	180
12	10	Mbikqyrja e Projekteve infrastrukturore	4,100.00	Shërbime Publike	180
13	10	Pastrimi i rrugëve	10,000.00	Shërbime Publike	180
14	10	Projekti për pyllzim	5,000.00	Shërbime Publike	180
15	10	Mbikqyrja e ndriqimit publik	7,900.00	Shërbime Publike	180
16	10	Sigurimi	10,000.00	Shërbime Publike	180
17	10	Festivali i Domates	18,000.00	Shërbime Publike	180
18	21	Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Topllua	45,000.00	Shërbime Publike	180
19	10	Paisje mjeksore aparate - Eho-Odefiblator dhe Monitor	20,774.00	Shëndetsia dhe Mirqenje Sociale	730
20	10	Renovimi i shkollës fillore	25,123.00	Arsim dhe Shkenca	920
		Gjithsejt Kapitale:	435,173.00		

Komuna e Mamushës

TABELA PËR INVESTIME KAPITALE 2015

Nr. Ren	Fondi	Emërtimi	Shuma	Drejtoria / Program	Kodi i Progr.
	Burimor		€		
1	10	Paisjet e IT	10,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
2	10	Mobilje	5,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
3	10	Ndërtimi objektit përcjllës për Administrat	21,200.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
4	10	Shtegu i lumit Topllua	62,000.00	Shërbime Publike	180
5	10	Rregullimi i rrugëve fushore bujqesore	35,000.00	Shërbime Publike	180
6	10	Shtuarja e rrugëve me kubeza	41,500.00	Shërbime Publike	180
7	10	Kanalizim (lagjia e re)	25,000.00	Shërbime Publike	180
8	10	Mbikqyrja e Projekteve infrastrukturore	6,000.00	Shërbime Publike	180
9	10	Pastrimi i rrugëve	10,000.00	Shërbime Publike	180
10	10	Projekti për pyllzim	5,000.00	Shërbime Publike	180
11	10	Mbikqyrja e ndriqimit publik	7,000.00	Shërbime Publike	180
12	10	Sigurimi	10,000.00	Shërbime Publike	180
13	10	Festivali i Domates	18,000.00	Shërbime Publike	180
14	21	Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Topllua	49,890.00	Shërbime Publike	180
15	10	Renovimi i shkollës fillore	5,922.00	Arsim dhe Shkenca	920
		Gjithsejt Kapitale:	311,512.00		

Komuna e Mamushës

TABELA PËR INVESTIME KAPITALE 2016

Nr. Ren	Fondi	Emërtimi	Shuma	Drejtoria / Program	Kodi i Progr.
	Burimor		€		
1	10	Paisjet e IT	5,700.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
2	10	Mobilje	3,000.00	Adminsirtata dhe Personeli	163
3	10	Shtegu i lumit Topllua	62,000.00	Shërbime Publike	180
4	10	Rregullimi i rrugeve fushore bujqesore	35,000.00	Shërbime Publike	180
5	10	Shtruarja e rrugeve me kubeza	41,500.00	Shërbime Publike	180
6	10	Kanalizim (lagjia e re)	25,000.00	Shërbime Publike	180
7	10	Mbikqyrja e Projekteve infrastrukturore	6,000.00	Shërbime Publike	180
8	10	Pastrimi i rrugeve	10,000.00	Shërbime Publike	180
9	10	Projekti per pyllzim	5,000.00	Shërbime Publike	180
10	10	Mbikqyrja e ndriqimit publik	7,000.00	Shërbime Publike	180
11	10	Sigurimi	10,000.00	Shërbime Publike	180
12	10	Krijimi i Korridoreve pergjate lumit Topllua	47,500.00	Shërbime Publike	180
13	10	Festivali i Domates	18,000.00	Shërbime Publike	180
14	21	Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Topllua	51,188.00	Shërbime Publike	180
15	10	Renovimi i shkollës fillore	5,922.00	Arsim dhe Shkenca	920
		Gjithsejt Kapitale:	332,810.00		